



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

14-020/04-85645/22, më 19-04-2022

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), të nenit 5, paragrafi 5.2 të Ligjit për ndërmarrjet publike 03/L - 087 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 31/15, qershor 2008), të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE PËR
NDËRMARRJEN PUBLIKE KOMUNALE "NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE" SH.A.

- I. Vllaznim Osmani, caktohet anëtar në komisionin komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike të Komunës së Prishtinës "Ndërmarrja Publike Banesore" Sh. A.
- II. Anëtar i cekur në pikën I të këtij vendimi së bashku me dy anëtarët të cilët i emëron Kuvendi i Komunës e përbëjnë komisionin komunal të aksionarëve për ndërmarrjen komunale "Ndërmarrja Publike Banesore" SH.A.
- III. Anëtar i komisionit komunal të aksionarëve, i caktuar me këtë vendim, ka të drejtë të veprojë në emër të Kryetarit të Komunës.
- IV. Veprimet e anëtarit të komisionit komunal të aksionarëve duhet të jenë në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike, Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe Ligjit për shoqëritë tregtare.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Anëtarit;
- NPL "Ndërmarrja publike banesore" sh.a.
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.

